



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.304/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lart ligjore Antigona Murati, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe INTERNEWS KOSOVA, paraqitur kundër koalicionit LDK-AKR për shkak të posterave afër qendrës së votimit në komunën e Mitrovicës, në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 15.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.304/2017 e datës 12.06.2017 parashtruar nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe INTERNEWS KOSOVA

A r s y e t i m

Me datën 12.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA në të cilën thekson se kandidati nga koalicioni LDK-AKR ka vendosur posterë në afërsi të vendvotimit 1109b. Sipas parashtruesit të ankesës kjo është shkelje e nenit 36 e LZP-së

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografisë së bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar:

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë te qarta dhe bindëse për të vërtetuar pretendimet ankimore edhe pse barra e të provuarit bie mbi parashtruesin e ankesës, në kuptim te nenit 117 par.3 të LZP-së, për te provuar pretendimet ankimore. Sepse nga fotografit e ofruar nuk mund të identifikohet në mënyrë

bindëse dhe të qartë objekti, dhe nëse e njëjta është duke u shfrytëzuar për të votuar si Qendër e Votimit, në ditën e votimit.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 304/2017 më datën 15.06.2017

Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.

